

30/03/26

NJOFTIM MBI MBLEDHJEN E RADHËS SË K.E.D. TË DATËS 30.03.2026

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), në përbërje të plotë të anëtarëve të tij dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të ftuar, në përputhje me pikën 2, të nenit 233 të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", zhvilloi të hënën, më datë 30.03.2026, mbledhjen e radhës, sipas rendit të ditës të publikuar në njoftimin zyrtar.

Pas prezantimit të relacioneve të përgatitura nga relatorët, për kandidatët që kanë aplikuar për vendet vakante të shpallura nga Institucioni i Presidentit të Republikës dhe Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vendosi:

Ndërprerjen e procedurave të verifikimit për kandidaturën e zj. Fatmira Luli, për vendin vakant të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë.

Shtyrjen e diskutimeve lidhur me kandidaturën e z. Alaudin Malaj, i cili kandidon për vendin vakant të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës, për në mbledhjen e radhës së KED.

Vijimin e procedurës së verifikimit të kriterëve pasurore nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit për kandidatët Roland Ilia dhe Lulzim Hamitaj, që kandidojnë për vendin vakant të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës.

Mbledhja e radhës do të zhvillohet në **datën 15 Prill 2026, ora 13.00.**

GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

GJYKATA E LARTË

Organizimi administrativ
Funksionimi
Organizimi juridik
Historiku

LISTA E GJYKIMEVE

Kërkesa për Pezullim, Revokim
Kërkesa për Konstatim shkelje afati
Kërkesa të veçanta për gjykim
Njoftime me shpallje për gjykim

VENDIMET E GJYKATËS

Vendime Pezullimi
Kompetenca
Juridiksione
Ankime të veçanta

NDIHMË PËR PUBLIKUN

Vendimet dhe botimi i tyre

Kur Gjykata e Lartë vepron me procedurë të përshpejtuar

Kjo rubrikë u krijua në zbatim të Ligjit nr.33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”



Të drejtat e rezervuara © 2026 Gjykata e Lartë

[Kontakt](#)

[Termet e Përdorimit](#)

[Indeksi](#)